

## Analiza e Financave Vendore për periudhën


### Janar - Qershor 2023

Miratimi i Ligjit nr.68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, e ka çuar procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor në një fazë të re konsolidimi. Për të ndjekur këtë proces, Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor, me qëllim monitorimin dhe asistencën e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar për 6 mujorin 2023, si dhe të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, është realizuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve 6 mujore të buxhetit vendor në nivel kombëtar.

#### Të ardhurat vendore

Për 6 mujorin e vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura në masën 15,362 milionë lekë, shifër kjo që është rreth 1.5 miliard lekë më pak ose rreth 9 përqind më e ulët se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2022. . Duke ndjekur ecurinë e realizimit të këtij treguesi deri në fund të 6 mujorit 2023, konstatohet që pushteti vendor ka mbledhur rreth 53% të planit vjetor të të ardhurave nga burimet e veta. Rënia e të ardhurave të veta të pushtetit vendor krahasuar me të njëjtën periudhë me një vit më parë reflekton gjithashtu ndikimin e treguesve të përgjithshëm makroekonomikë. Në këtë drejtim, pushteti vendor ka pësuar uljen e mbledhjes së disa taksave dhe tarifave vendore, kryesisht “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, ulja e të cilës vlerësohet që vjen si pasojë e uljes së vlerës së investimeve të reja në ndërtim në këtë periudhë krahasuar me një vit më parë, apo edhe apo “tarifat e pastrimit dhe higjenës”. Megjithatë kjo rënie prej 9% në performancën e të ardhurave të veta të pushtetit vendor, vlerësohet se pushteti vendor mund ta rikuperojë në pjesën e mbetur të vitit.


Grafiku 1: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Ndër vite, të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për 6 mujorin e parë të vitit nga *taksat lokale*, janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 78.2% të shumës totale të këtyre të ardhurave për 6 mujorin e vitit 2023. Nga ana tjetër nga *taksa e pasurisë* (ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore) janë mbledhur rreth 3.3 miliard lekë apo rreth 21.6% e totalit të të ardhurave vendore. Kurse taksa mbi biznesin e vogël ka ardhur duke u zvogëluar pas ndryshimeve fiskale ligjore. Grafikisht këto ndryshime strukturore të të ardhurave vendore paraqiten si më poshtë:

**Grafiku 2: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Taksa e pasurisë

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Kjo taksë është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore në diskrecion të plotë të përdorimit. Për 6 mujorin e vitit 2023, grupi i taksave mbi pasurinë ku përfshihet, ndërtesa, trualli, toka bujqësore dhe transaksioni i pasurisë përbën 21.6 % të totalit të të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor. Në vlerë absolute, nga taksat mbi pasurinë janë mbledhur rreth 3.3 miliardë lekë, shifër kjo që është rreth 344 milion lekë më e ulët se vlera e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2022. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë, nëse marrim në analizë 6 mujorin në vite do të kemi rezultatet si në grafikun e mëposhtëm:

**Grafiku 3: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa e pasurisë**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

### Taksat Lokale

Nga të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë taksat lokale, duke qenë kështu burimet më të rëndësishme të financimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga të ardhurat e veta, të cilat gjithmonë e më shumë po konsolidohen në këndvështimin financiar dhe këtë e dëshmon rritja e të ardhurave nga ky burim nga viti në vit. Për 6 mujorin 2023 këto taksa zënë rreth 78.2% të shumës totale të të ardhurave tatimore të pushtetit vendor. Të ardhurat nga taksat lokale kanë konsoliduar trendin në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale, megjithatë për 6 mujorin e vitit 2023 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 12 miliard lekë, shifër kjo që është rreth 1.1 miliard lekë më e ulët se vlera e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2022. Në këtë grup të taksave, vërejmë se pjesën më të madhe të tyre e zë “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, që sipas të dhënave të 6 mujorit 2023 vërehet se ka një ulje të konsiderueshme. Kjo rënie e të ardhurave nga ky burim vjen edhe si pasojë e uljes së investimeve të reja në ndërtim në këtë periudhë, krahasuar me një vit më parë.

**Grafiku 3: Të ardhurat nga taksa lokale dhe ritmi i ndryshimit të tyre**



**Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)**

### Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore është bërë zero (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Kjo lehtësi fiskale që u miratua nga buxheti qendror iu kompensua pushtetit vendor në rritjen e transfertave nga qeveria qendrore. Nga realizimi faktik gjatë 6 mujorit të vitit 2023, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 33 milion lekë, që zënë vetëm 0.2% të të ardhurave vendore në 6 mujorin 2023, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë. Disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin detyrime nga ky burim për ato subjekte të cilat nuk kanë kryer pagesat brenda afatit dhe rezultojnë debitorë.

### Të ardhura të tjera jostatimore të Pushtetit Vendor

Një burim tjetër i rëndësishëm i të ardhurave të veta vendore që lidhet drejtëpërdrejt me aktivitetin e pushtetit vendor, janë të ardhurat jostatimore. Për 6 mujorin e vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura jostatimore në masën mbi 1,472 milion lekë, shifër rreth 108 milion lekë më e ulët se vlera e të ardhurave jo tatimore të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2022.


### **Shpenzimet vendore**

Shpenzimet e pushtetit vendor kanë një kontribut të rëndësishëm në mirëqënien e qytetarëve, e si rrjedhim ato paraqesin tendenca zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Objektivi kryesor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me shpenzimet e përgjithshme apo ndaj produktit të brendshëm bruto, përbën një tregues të rëndësishëm për vlerësimin e ecurisë pozitive të reformave në menaxhimin financiar në nivel vendor në drejtim të thellimit të decentralizimit fiskal.

Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore evidentohen si një tregues financiar në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vjen si pasojë e përmirësimit të nivelit të shërbimeve apo funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët, të financuara këto si nëpërmjet mbështetjes financiare nga qeveria qendrore në formën e transfertave, po ashtu edhe nëpërmjet rritjes së të ardhurave të veta vendore. Rritja e kompetencave, hapësirës territoriale në administrim dhe sigurisht numrit të banorëve të një bashkie ka bërë që tashmë ato të rrisin përgjegjësinë, transparencën e konsultimin publik, si dhe llogaridhënien në përdorimin e financave publike vendore.

Buxheti vendor për 6 mujorin e parë të vitit 2023, nga të dhënat faktike të thesarit rezultojnë të jetë realizuar në masën 28.9 miliard lekë, rreth 4.2 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë ose rritje me 17%. Nga analiza e të dhënave vihet re që të gjithë zërat e shpenzimeve korente kanë rritje, por pjesën më të madhe të kësaj rritjeje të shpenzimeve vendore krahasuar me një vit më parë e kanë, shpenzimet e personelit, shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale nga viti paraardhës.


**Grafiku 6: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre**



**Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)**

Shpenzimet e pushtetit vendor në vite sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qendrueshmërisë së shpenzimeve të personelit, e shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë përmes përdorimit në formën e shpenzimeve operative. Për 6 mujorin 2023 në tërësi, pothuajse të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë pësuar rritje në raport me 6 mujorin e vitit 2022, siç konstatohet edhe nga grafiku më poshtë:

**Grafiku 7: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës buxhetore**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 6 mujorit të vitit 2023 dhe 6 mujorit të vitit 2022:

**Tabela 1: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)**

Nr	EMËRTIMI	Fakt 6 mujori		Diferenca	
		2023	2022	2023 ndaj 2022 në vlerë	2023 ndaj 2022 në %
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga Pushteti vendor</b>	<b>15,362</b>	<b>16,851</b>	<b>-1,489</b>	<b>91%</b>
I.1	Taksa mbi pasurinë	3,314	3,659	-345	91%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	33	40	-7	83%
I.3	Taksa Lokale	12,015	13,153	-1,138	91%
<b>II.</b>	<b>Shpenzime nga Pushtetit Vendor</b>	<b>28,957</b>	<b>24,735</b>	<b>4,222</b>	<b>117%</b>
II.1	<b>Shpenzime Korente</b>	22,780	20,385	2,395	112%
	Personeli	14,040	12,181	1,859	115%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	7,729	7,395	334	105%
	Subvencione	221	82	139	270%
	Te tjera	790	727	63	109%
II.2	<b>Shpenzime Kapitale</b>	6,177	4,350	1,827	142%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet e Personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësite të veqeverisjes vendore me rreth 48.5%. Për 6 mujorin e vitit 2023 këto shpenzime janë realizuar në masën 14 miliard lekë ose rreth 1.8 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2023, vjen si rrjedhojë kryesisht edhe nga politika që

u ndërmorr këtë vit për rritjen e pagave. Pushtetit vendor iu akorduan si shtesë fondesh nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave rreth 400 milion lekë për punonjësit e funksioneve sektoriale dhe rreth 743 milion lekë për nëpunësit civil dhe punonjësit e administratave të bashkive, ndërkohë që një pjesë të efektit financiar të rritjes së pagave është përballuar edhe nga vetë njësitë vendore dhe si rrjedhim shpenzimet e personelit kanë pësuar rritje të konsiderueshme krahasuar më një vit më parë.

Shpenzimet Operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Këto shpenzime në 6 mujorin 2023 rezultojnë me një rritje sipas të dhënave faktike të thesarit. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 26.7% të shpenzimeve në total për 6 mujorin e parë të vitit 2023, një pjesë kjo e konsiderueshme për buxhetin njësisive të vetëqeverisjes vendore. Këto shpenzime gjatë periudhës 6 mujore 2023 janë realizuar afërsisht në masën 7.7 miliard lekë ose rreth 334 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipërme në raport me 6 mujorin e parë të vitit 2022, këto shpenzime për të njëjtën periudhë në vitin 2023 janë rritur me 170% ose 139 milion lekë për zërin subvencione. Ndërkohë, shpenzimet e tjera janë realizuar në masën rreth 790 milion lekë ose rreth 76 milion lekë apo 11% më shumë se 6 mujori i parë i vitit 2022.

Shpenzimet Kapitale janë një zë mjaft i rëndësishëm në buxhetin vendor, për shkak sepse këto shpenzime sjellin në mënyrë direkte dhe indirekte zhvillim ekonomik dhe për rrjedhojë ndikojnë mirëqënien e qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me një vit më parë gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023 shpenzimet për investime janë rritur në mënyrë të konsiderueshme me rreth 1.8 miliard lekë. Rikthimi i ekonomisë në situatën normale është reflektuar edhe në rritjen me rreth 42% më shumë investime krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

**Fondi i rindërtimit** që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përdorur për rimëkëmbjen pas tërmetit është një pjesë tjetër e shpenzimeve që i kalon buxhetit vendor. Financimi për NJVQV-të në vitin 2023 (çelur deri në fund të 6 mujorit, ku përfshihet edhe mbartja e fondit të akorduar me VKM, por e papërdorur në vitin 2022), është rreth 6.3 miliard lekë, ndërkohë që përdorimi i tij për pushtetin vendor deri në fund të 6 mujorit 2023 është rreth 3.5 miliard lekë. Shpenzimet e fondit të rindërtimit paraqiten më të detajuara të ndarë sipas zërave buxhetorë në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2: Shpenzimet e fondit të rindërtimit akorduar për pushtetin vendor sipas natyrës (në milion lekë)**

E M Ë R T I M I	Buxhet total 6-mujor	Fakt 6 mujor
	2023	
<b>Fondi i Rindërtimit</b>	<b>6,347</b>	<b>2,816</b>
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,238	1,614
<i>Shpenzime operative e mirëmbajtjeje</i>	494	26
<i>Transferta për familjet dhe individët</i>	2,614	1,175

*Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)*